

LIGJ
Nr.8410, datë 30.9.1998

PËR RADION DHE TELEVISIONIN PUBLIK E PRIVAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

(Ndryshuar me ligjin nr. Nr. 8655, datë 31.7.2000; nr. 8794, datë 10.5.2001)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj rregullon veprimtarinë e radios dhe televizionit publik e privat në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Veprimtaria radiotelevizive

Veprimtaria radiotelevizive përfshin prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji me anë të zërit, figurës, sinjaleve të koduara, shkrimit, të destinuara për publikun nëpërmjet valëve elektromagnetike, kablllove, përsëritësve, satelitëve apo me çdo mjet tjetër.

Neni 3
Baza ligjore e veprimtarisë radiotelevizive

Veprimtaria radiotelevizive zhvillohet në përputhje me ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, me dispozitat e këtij ligji, me ligjin nr.8288, datë 18.2.1998 "Për Entin Rregullator të Telekomunikacioneve", me ligjin nr.7564, datë 19.5.1992 "Për të drejtën e autorit", ndryshuar me ligjin nr.7923, datë 19.4.1995, si dhe me dispozitat e tjera ligjore që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Për të ushtruar një veprimtari radiotelevizive private, çdo subjekt fizik apo juridik pajiset me licencë.

Neni 4
Parimet themelore të zhvillimit të veprimtarisë radiotelevizive

Veprimtaria radiotelevizive është e lirë.

Veprimtaria radiotelevizive respekton paanshmërisht të drejtën për informacion, bindjet politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin, jetën private të njeriut, si dhe të drejtat e liritë

themelore të tij. Në këtë veprimtari respektohen në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve.

Veprimtaria radiotelevizive nuk lejohet të cenojë rendin kushtetues, sovranitetin dhe integritetin kombëtar.

Neni 5

Pavarësia editoriale sigurohet me ligj.

Punësimi, ngritja në detyrë, si dhe të drejtat dhe detyrat e punonjësve të radiove dhe televizioneve publike dhe private nuk përcaktohen nga seksi, origjina, pikëpamjet politike, besimi fetar apo anëtarësia në sindikata.

KREU II KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT

Neni 6

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

Për rregullimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë radiotelevizive në Republikën e Shqipërisë krijohet Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT), i cili është organizëm i pavarur, që vepron në bazë e për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

Neni 7

Kompetencat

(Ndryshuar pika 3 dhe 20 me ligjin nr. Nr. 8655, datë 31.7.2000; ndryshuar pika 3 dhe shtuar pika 1/a dhe 18/b me ligjin nr. 8794, datë 10.5.2001)

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ka këto kompetenca:

1. Kontrollon zbatimin e këtij ligji dhe të ligjeve të tjera për mediat nga subjektet që ushtrojnë veprimtari radiotelevizive, publike e private, në territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Monitoron programet informative të transmetuara nga operatorët radiotelevizivë kombëtarë. Kur e gjykon të arsyeshme, KKRT-ja monitoron edhe programet informative të transmetuara nga operatorët radiotelevizivë lokalë.
3. Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit administron spektrin e radiofrekuencave të caktuara për transmetime radioje dhe televizive, në përputhje me përcaktimet për shërbimin radiodifuzion në "Planin kombëtar të radiofrekuencave" të miratuar nga Këshilli i Ministrave.
4. Garanton konkurrencën e ndershme në fushën e mediave elektronike, duke siguruar njëkohësisht zhvillimin e mëtejshëm të Radios dhe Televizionit publik shqiptar.
5. U jep dhe u heq licencat subjekteve private për transmetim programesh radiotelevizive, përfshirë teletekstin, në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe kontrollon respektimin e kushteve të përcaktuara në licencë. Shqyrtimi i kërkesave për licenca bëhet në mënyrë publike. Vendimet e tij për dhënien e heqjen e licencave botohen në Fletoren Zyrtare.
6. Harton rregulloren me kriteret për dhënien e licencave në përputhje me këtë ligj. Organizon dhënien e tyre dhe garanton barazinë e trajtimit të kërkesave. Njofton arsyet e refuzimit, pezullimit ose të heqjes së licencës dhe shqyrton ankimin e subjektit që pretendon se është cenuar, i cili në çdo rast mund t'i drejtohet për ankesë gjykatës.
7. Jep dhe heq licenca për instalimin e përsëritësve radiotelevizivë të programeve të huaja për zona të ndryshme të vendit.
8. Jep dhe heq licenca për ritransmetim të radiove dhe televizioneve të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë për publikun në Shqipëri.

9. U jep autorizime operatorëve publikë dhe privatë shqiptarë për transmetime nga Shqipëria në drejtim të vendeve të tjera (për të tretë), duke respektuar konventat ndërkombëtare.

10. Cakton norma prodhimi dhe transmetimi për mediat elektronike publike dhe private lidhur me aspekte të ndryshme të zbatimit të këtij ligji.

11. Vendos zbatimin e sanksioneve të përcaktuara në këtë ligj për subjektet që veprojnë në kundërshtim me këto dispozita, si dhe, sipas rastit, kërkon ndërhyrjen e organeve të tjera sipas kompetencës së tyre.

12. Mban regjistrat, skedat dhe arkivin e licencave, si dhe dokumentacionin që lidhet me to, duke pasqyruar të gjitha ndryshimet e mëvonshme.

13. Kërkon nga administrata shtetërore, gjykatat, bankat dhe organizma të tjerë përkatës, si dhe nga titullarët e subjekteve të licencuar informacione që i gjykon të nevojshme për të kontrolluar vërtetësinë e të dhënave të paraqitura nga kërkuesi i licencës para dhënies së saj ose në çdo çast tjetër. Këto të dhëna përdoren vetëm për zbatimin e detyrave të ngarkuara nga ky ligj. Përhapja dhe botimi i tyre nuk lejohet.

14. Jep mendim për perspektivën e veprimtarisë radiotelevizive.

15. Shpreh zyrtarisht propozimet e tij për nënshkrimin dhe zbatimin korrekt të marrëveshjeve ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me transmetimet radiotelevizive.

16. Merr pjesë në veprimtari ndërkombëtare në lidhje me strategjinë dhe perspektivat e zhvillimit të radios dhe televizionit, duke përfaqësuar Shqipërinë dhe mbështet pjesëmarrjen e bashkëpunimin e subjekteve publike e private me organizata homologe europiane e botërore në fushën e programeve dhe të transmetimeve radiotelevizive. Përgatit studime me rekomandime për qëndrimin e Shqipërisë në bisedimet ndërkombëtare zyrtare mbi transmetimet radiotelevizive.

17. Sugjeron ndryshime të legjislacionit dhe të rregulloreve, të cilat diktohen nga evolucioni teknologjik, ekonomik, social dhe kulturor në fushën e mjeteve elektronike të komunikimit masiv.

18. Harton strukturën organizative dhe rregulloren e brendshme të administratës së KKRT-së.

18/a. Miraton projektbuxhetin vjetor të KKRT-së, shqyrton dhe miraton bilancin vjetor të KKRT-së, si dhe raportin vjetor mbi veprimtarinë e KKRT-së përpara se t'i paraqitet Komisionit Parlamentar për Mjetet e Informimit Publik.”

18/b. Miraton strukturën organike dhe numrin e punonjësve të administratës së KKRT-së, si dhe emëron e shkarkon drejtorët në administratën e KKRT-së, në përputhje me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil”.

19. Raporton në fillim të çdo viti për veprimtarinë vjetore të KKRT-së dhe mënyrën se si janë respektuar nga rrjeti publik dhe privat detyrimet që rrjedhin nga ky ligj. Raportin e paraqet para Komisionit të Përhershëm për Mjetet e Informimit Publik dhe para Kuvendit Popullor në seancë plenare.

Nëse për dy vjet radhazi Kuvendi Popullor nuk e miraton raportin vjetor për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit me 2/3 e votave, atëherë ai shpërndahet. KKRT-ja rizgjidhet sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj, jo më vonë se 30 ditë pas shpërndarjes së pararendëses.

20. Kontrollon cilësinë e marrjes së sinjaleve në zonat e licencuara dhe kërkon zgjidhje për ankesat e publikut për cilësinë e transmetimit të sinjaleve radiotelevizive.

21. Nxjerr vendime në zbatim të këtij ligji.

Neni 8
Përbërja

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari

dhe pesë anëtarë, të cilët janë personalitete të jetës shoqërore, kulturore, juridike, ekonomike, edukative, të medias dhe të teknikës radiotelevizive. KKRT-ja vepron në mënyrë të pavarur në përputhje me këtë ligj.

Buxheti i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit përballohet nga shteti në një masë të tillë që të lejojë funksionimin normal të tij. Kryetari dhe zëvendëskryetari i KKRT-së barazohen në pagë me atë të një ministri dhe zëvendësministri. Kryetari dhe zëvendëskryetari, pas zgjedhjes së tyre, janë të punësuar pranë KKRT-së. Shpërblimet për anëtarët e këtij Këshilli caktohen nga Kuvendi Popullor.

Neni 9 **Zgjedhja**

Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit zgjidhen nga Kuvendi Popullor për një periudhë 5-vjeçare, jo më tepër se 2 herë radhazi. Presidenti i Republikës i propozon Kuvendit Popullor kandidaturën për 1 anëtar, kurse 6 kandidaturat e tjera propozohen nga Komisioni i Përhershëm për Mjetet e Informimit Publik në përfaqësim të barabartë midis pozitës dhe opozitës parlamentare.

Kryetari i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit zgjidhet nga Kuvendi Popullor ndërmjet 7 anëtarëve të tij mbi bazën e 2 kandidaturave të propozuara me votim të fshehtë nga KKRT-ja.

Zëvendëskryetari i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit zgjidhet nga vetë KKRT-ja me votim të fshehtë mbi bazën e 2 kandidaturave.

Kryetari dhe zëvendëskryetari i mandatit të parë të KKRT-së zgjidhen për një periudhë 6-vjeçare, në mënyrë që të sigurohet vijimësia e funksionimit të KKRT-së gjatë ndërrimit 5-vjeçar të anëtarëve në mandatet e ardhshme.

Neni 10 **Organizimi dhe funksionimi i KKRT-së** *(Ndryshuar me ligjin nr. 8794, datë 10.5.2001)*

Pranë Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit vepron administrata e tij, e cila realizon gjithë veprimtarinë e nevojshme përgatitore e administrative në shërbim të Këshillit.

Struktura organizative e administratës së KKRT-së përbëhet nga departamente e drejtori. Struktura e administratës, kriteret e punësimit, si dhe struktura e pagave përcaktohen nga KKRT-ja sipas modeleve të institucioneve të ngjashme të pavarura. Sigurimet shoqërore, pensionet suplementare, si dhe privilegjet e tjera ligjore në fuqi për institucionet e të njëjtit nivel zbatohen dhe për administratën e KKRT-së.

Funksionimi i brendshëm i KKRT-së, procedurat e vendimmarrjes dhe zbatimi i tyre, hartuar sipas dispozitave në fuqi, propozohen nga Kryetari dhe miratohen nga Këshilli.

Neni 10/a **Kompetencat e Kryetarit të KKRT-së** *(Shtuar me ligjin nr. 8794, datë 10.5.2001)*

Kryetari është drejtues ekzekutiv i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit.

Kryetari ushtron këto detyra kryesore:

a) organizon, bashkërendon e drejton veprimtarinë e KKRT-së dhe të administratës së KKRT-së në përputhje me ligjin dhe rregulloret e KKRT-së;

b) i propozon KKRT-së tematikën e mbledhjeve, rendin e ditës, problemet që do të shqyrtohen me projektvendimet e relacionet përkatëse;

c) emëron e shkarkon punonjësit e administratës së KKRT-së, sipas dispozitave në fuqi për shërbimin civil dhe marrëdhëniet e punës, me përjashtim të punonjësve që janë emërtësë e vetë Këshillit;

ç) përfaqëson KKRT-në në marrëdhëniet me të tretët dhe me organizatat ndërkombëtare;

d) raporton në Kuvend për veprimtarinë vjetore të KKRT-së.

Në zbatim të detyrave të veta, Kryetari nxjerr urdhra dhe udhëzime për administratën.

Në mungesë të Kryetarit, funksionet e tij i kryen Zëvendëskryetari.

Neni 11

Financimi i KKRT-së

(Ndryshuar paragrafi I fundit me ligjin nr. 8794, datë 10.5.2001)

Burimet e financimit të KKRT-së janë:

- të ardhurat nga pagesat për marrjen dhe rinovimin e licencave;

- të ardhurat nga pagesat vjetore të licencës;

- të ardhurat nga përpunimi i kërkesave për licencim;

- të ardhurat nga taksat për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive të caktuara në ligjet fiskale;

- financime nga buxheti i shtetit;

- dhurimet.

Tarifat për marrjen dhe rinovimin e licencave për transmetim radioje dhe televiziv, si dhe tarifat vjetore për licencat e operatorëve privatë radioje FM dhe operatorëve privatë televizivë tokësorë analogjikë përcaktohen në këtë ligj sipas lidhjes 1 bashkëlidhur.

Tarifat vjetore për ritransmetimin e programeve të huaja me përsëritës, tarifat vjetore për transmetime radiotelevizive me kabëll dhe me satelit, tarifat për marrjen dhe për rinovimin e licencave për ta, pagesat për përpunimin e kërkesave për licensim, kriteret dhe mënyra e kryerjes së tyre caktohen nga KKRT-ja.

Neni 12

KKRT-ja mban llogarinë e të ardhurave dhe shpenzimeve në përputhje me legjislacionin shqiptar të kontabilitetit.

Neni 13

KKRT-ja mund të përfitojë edhe nga dhurimet financiare ose materiale. Dhurimet pranohen pa kushte dhe përdoren për nevojat e punës sipas vlerësimit të KKRT-së. Dhurimet deklarohen dhe shënohen në një regjistër që administrata e KKRT-së mban posaçërisht për këtë qëllim. Në fund të vitit KKRT-ja detyrohet të çojë një kopje të regjistrit, hyrjet dhe daljet, në Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe një kopje tjetër në Komisionin e Përhershëm për Mjetet e Informimit Publik. Regjistri përcakton llojin e ndihmës, masën, kohën, subjektin që jep dhurimin dhe mënyrën e lëvrimit të dhurimit. Regjistri përmban edhe identitetin dhe firmën e dhuruesit.

Neni 14

Papajtueshmëritë

(Shtuar paragraf pas pikës 4 me ligjin nr. 8794, datë 10.5.2001)

Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit nuk lejohen:

1. të jenë anëtarë të partive dhe shoqatave politike, deputetë ose anëtarë të Qeverisë dhe as të deklarohen publikisht apo të veprojnë në interes të tyre;

2. të jenë anëtarë të shoqërive anonime, që kanë lidhje me mjetet e informimit masiv ose të përfaqësojnë interesa tregtarë që janë në kundërshtim me funksionin e tyre;

3. të lidhen me interesa financiare që kanë të bëjnë me transmetimet në radio dhe televizion nëpërmjet pronësisë, marrëdhënieve të punësimit ose tregtare;

4. të mbrojnë interesat e një shoqërie apo firme prodhimesh audiovizuale, botimesh shtypi, reklame ose telekomunikacioni.

Gjatë gjithë kohëzgjatjes së detyrës, anëtarët e KKRT-së nuk lejohet të shprehen a të mbajnë qëndrime publike që cenojnë paanshmërinë e tyre në raport me interesat e përfaqësuar në pikat 1 deri 4 të këtij neni.

Detyrimet e parashikuara në pikat 3 dhe 4 të këtij neni do të vazhdojnë të jenë në fuqi për një vit pas mbarimit të mandatit të anëtarëve të KKRT-së.

Punonjësit e administratës së Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit nuk lejohet të jenë anëtarë të bordeve administruese të rrjeteve transmetuese publike e private, nuk lejohet të jenë të licencuar për transmetime radiotelevizive, nuk lejohet të mbrojnë interesat e një subjekti që ka marrë licencë radiotelevizive apo të ushtrojnë funksione në shërbim të tij.

Neni 15

Lirimi nga detyra

1. Kryetari, zëvendëskryetari dhe çdo anëtar i KKRT-së lirohet nga detyra nga organi që e zgjedh kur:

- dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- bëhet i paaftë për të kryer detyrën për shkak sëmundjeje;
- mungon brenda 1 viti në më shumë se 1/3 e mbledhjeve të Këshillit;
- vërtetohet se nuk plotëson detyrimet e nenit 14.

2. Kryetari, zëvendëskryetari dhe çdo anëtar i KKRT-së mund të japë dorëheqjen me shkrim në çdo kohë.

3. Në çdo rast lirimi zgjidhet një zëvendësues, duke ndjekur procedurën e parashikuar për zgjedhjen dhe për një kohë të barabartë me kohën që i kishte mbetur pararendësit që u lirua.

Neni 16

Detyrimi për ruajtjen e sekretit

Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit dhe nëpunësit administrativë të KKRT-së detyrohen të ruajnë sekretin profesional për faktet, informacionet dhe aktet për të cilat janë vënë në dijeni për shkak të detyrës që ata kryejnë. Për shkeljet në këtë drejtim, mbajnë përgjegjësi sipas dispozitave ligjore.

Neni 17

Kuorumi

(Ndryshuar me ligjin nr. 8794, datë 10.5.2001)

Vendimet, rekomandimet, vërejtjet dhe opinionet e Këshillit miratohen kur shumica e anëtarëve të Këshillit janë të pranishëm dhe me shumicën e votave.

Thirrja e Mbledhjeve të KKRT-së, procedura e vendimmarrjes dhe forma e votimit bëhen sipas dispozitave që përcakton ligji nr. 8480, datë 23.5.1999 “Për funksionimin e

organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.

Projektet e akteve të veta normative KKRT-ja ia dërgon për konsultim shoqatave të operatorëve radiotelevizivë. Mendimet e paraqitura nga shoqatat i bëhen të njohura Këshillit përpara marrjes së vendimit.

Këshilli mbledhet të paktën një herë në muaj.

KREU III KËSHILLI I ANKESAVE

Neni 18

1. Këshilli i Ankesave për Radion dhe Televizionin është organizëm këshillimor pranë Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit.

Këshilli i Ankesave caktohet nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit.

Ky Këshill përbëhet nga kryetari dhe 2 anëtarë, specialistë të fushës së medias, të cilët emërohen për një periudhë 3-vjeçare, me të drejtë riemërimi jo më shumë se 1 herë.

2. Objekti i punës së Këshillit të Ankesave është sensibilizimi i opinionit publik për të përgjegjësuar entet radiotelevizive publike dhe private që të realizojnë normat morale dhe etike në programet e tyre.

3. Këshilli i Ankesave mbikëqyr, sidomos, programet radiotelevizive publike e private që kanë të bëjnë me shfaqjet e keqpërdorimit të dhunës, seksit dhe të dinjitetit. Për këtë qëllim Këshilli ka të drejtë të kërkojë e të marrë për studim çdo material audioviziv, që ai e vlerëson të nevojshëm për objektin e punës së tij, vetëm pasi ky të jetë transmetuar.

4. Ankesat ndaj programeve radiotelevizive publike e private, që shqetësojnë opinionin publik, shqyrtohen nga Këshilli i Ankesave brenda 2 muajve nga data e transmetimit.

5. Këshilli i Ankesave organizon anketime të publikut për problemet etike dhe morale të programeve radiotelevizive publike e private. Konkluzionet që nxjerr nga anketimet dhe nga ankesat e publikut ia bën të njohura Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, si dhe të gjitha mjeteve të informimit publik të medias elektronike, të cilat janë të detyruara t’i publikojnë këto konkluzione. çdo 6 muaj këto konkluzione Këshilli i Ankesave i boton në një buletin të veçantë.

6. Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Ankesave përcaktohet dhe përballohet nga KKRT-ja.

KREU IV LICENCIMI

Neni 19

Licenca

(Ndryshuar paragrafi I dytë me ligjin nr. Nr. 8655, datë 31.7.2000)

Licenca e transmetimit radioteleviziv vlen si leje për instalimin e pajisjeve teknike dhe i jep subjektit privat të drejtën për transmetim. Ajo duhet të përmbajë kërkesat e nenit 23 të këtij ligji, të drejtat e detyrimit e subjektit që kërkon të licencohet dhe të përcaktojë kushtet teknike e programore që duhen plotësuar për të realizuar transmetimin.

Licenca autorizon shfrytëzimin e rrjeteve të trasmetuesave me shtrirje kombëtare ose lokale dhe përcakton frekuencat e punës, fuqinë, vendvendosjen, zonën e mbulimit, si dhe elemente të tjera që përcaktohen në këtë ligj dhe në rregulloret e KKRT-së.

Neni 20

Dispozita të përgjithshme për licencime

(Ndryshuar me ligjin nr. Nr. 8655, datë 31.7.2000; ndryshuar me ligjin nr. 8794, datë 10.5.2001)

Licencat janë dy llojesh: kombëtare dhe vendore.

Licencat për transmetim televiziv ose radioje në shkallë kombëtare u jepen shoqërive anonime që themelohen me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë me objekt ekskluziv veprimtarinë radiotelevizive. Aksionet që përfaqësojnë kapitalin në një shoqëri, mbajtëse të një licence për transmetim televiziv ose radio, janë nominative.

Asnjë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, nuk duhet të ketë më shumë se 40 për qind të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë.

Mbledhjet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të asamblesë së shoqërisë anonime, me objekt të vetëm veprimtarinë për transmetime televizive ose radio, janë të vlefshme kur në to marrin pjesë jo më pak se dy të tretat e mbajtësve të aksioneve.

Një person fizik ose juridik, që ka aksione në një shoqëri televizive ose radioje kombëtare, nuk lejohet të jetë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, pjesëmarrës në një shoqëri të dytë televizive ose radioje kombëtare, si dhe nuk i lejohet të marrë licencë për transmetim televiziv ose radioje vendore.

Licencat për transmetim televiziv ose radioje vendore me modulim në frekuencë u jepen personave juridikë e fizikë të regjistruar në territorin e Republikës së Shqipërisë me objekt ekskluziv veprimtarinë radiotelevizive. Të njëjtit subjekt nuk i jepet licencë për më shumë se dy zona transmetimi vendor. Licenca për transmetim vendor në zonat urbane me mbi 200 000 banorë nuk u jepet personave fizikë.

I njëjti subjekt që zotëron një licencë për transmetim televiziv vendor mund të marrë vetëm një licencë të dytë për transmetim radioje vendor.

I njëjti subjekt që zotëron një licencë për radioje vendore mund të marrë vetëm një licencë të dytë për transmetim televiziv vendor.

Mbajtësi i licencës për transmetim radioteleviziv kombëtar duhet të realizojë mbulimin e mbi 70 për qind të territorit të vendit. Brenda 6 vjetësh ky mbulim duhet të arrijë të përfshijë deri në 90 për qind të territorit dhe jo më pak se 90 për qind të popullsisë.

Mbajtësi i licencës për transmetim televiziv ose radioje kombëtare ose vendore është i detyruar të realizojë mbulimin e zonës së caktuar në licencë në përputhje me normat teknike të transmetimit. Zbatimi i normave teknike të transmetimit monitorohet nga KKRT-ja.

Me termin "transmetim televiziv ose radioje vendore", sipas këtij ligji nënkuptohet mbulimi me sinjal televiziv ose radioje nga operatorët televizivë ose radioje të licencuar, si të tillë, i territorit të komunave, bashkive, deri në hapësirën administrative të dy prefekturave (zona e transmetimit), kur ato formojnë një entitet gjeografik dhe që ofrojnë burime të mjaftueshme financiare për prodhim dhe transmetim programesh televizive ose radio.

I ndalohet huazimi i emrit, në çdo lloj mënyre, çdo subjekti fizik ose juridik, vendas ose i huaj, që kandidohet për marrjen e një licence për veprimtari radioje ose televizive.

Neni 21

Procedura e dhënies së licencës

Licenca jepet nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i cili organizon për këtë qëllim konkurrim kandidaturash për kërkesat e depozituara. Kandidaturat që fitojnë shpallen publikisht.

Radiotelevizioni publik Shqiptar nuk ka nevojë për licencë.

Neni 22

Vlefshmëria e licencës

Licenca e transmetimit është e patjetërsueshme dhe vlen vetëm për subjektin të cilit i është dhënë. Në rast se mbajtësi i licencës hyn në marrëdhënie juridike civile, objekt i të cilave është edhe veprimtaria radiotelevizive e licencuar, atëherë për cedimin ose kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca kërkohet miratimi i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit. Subjektit që ka fituar këto të drejta, miratimi i jepet në formën e një licence të re me të njëjtën përmbajtje. Kur Këshilli nuk e miraton kalimin për shkaqe të parashikuara në këtë ligj, i ofron frekuencat që i përkasin kësaj licence për një konkurrim të ri kandidaturash.

Neni 23

Kërkesa për licencë

(Ndryshuar pika 5 me ligjin nr. Nr. 8655, datë 31.7.2000; shfuqizuar pika 5 me ligjin nr. 8794, datë 10.5.2001)

Kërkesa për marrjen e licencës së transmetimit radioteleviziv përmban:

1. emërtimin, vendndodhjen, formën ligjore të subjektit që bën kërkesën bashkë me emrin dhe firmën e personit që ka të drejtë ta përfaqësojë atë;
2. dokumentet që vërtetojnë të dhëna zyrtare e bankare mbi kapitalin financiar të personit juridik apo fizik që bën kërkesën;
3. emërtimin e programit dhe të stacionit transmetues;
4. objektin dhe karakteristikat e përgjithshme të shërbimit, të dhëna për kohëzgjatjen e programeve dhe territorin që do të mbulojë, si dhe projektin teknik të instalimit dhe shfrytëzimit të aparaturave;
5. Shfuqizuar.
6. listën e administratorëve, parashikimet për shpenzimet dhe të ardhurat, origjinën dhe shumën e financimeve të parashikuara për kohëzgjatjen për të cilën kërkohet licenca;
7. listën emërore të anëtarëve të Bordit Drejtues dhe curriculum vitae të tyre. Numri minimal i anëtarëve të Bordit për çdo subjekt të licencuar përcaktohet në rregulloren e KKRT-së;
8. përmbajtjen e programeve që do të transmetohen dhe strukturën programore të propozuar për transmetim, të cilat të shprehin qartë pluralizmin në tërësinë e tyre dhe paanësinë e informacionit;
9. raportin e kohës së transmetimit që do të zënë emisionet e prodhuara vetë dhe atyre të prodhuara në vend në përpjesëtim me emisionet e tjera.

Neni 24

Vendimi për dhënien e licencës

Vendimi për dhënien ose mosdhënien e licencave jepet brenda 90 ditëve pas afatit të dorëzimit të kërkesave.

Për kërkesën që miratohet, në vendim shënohen përmbajtja dhe sasia e programeve në përputhje me këtë ligj, kushtet teknike të transmetimit, afati dhe tarifat vjetore që i caktohen të licencuarit.

Vendimi për dhënien e licencës botohet në Fletoren Zyrtare në numrin më të afërt të saj. I licencuari regjistrohet në organet tatimore.

Neni 25
Afati i licencës

Licenca për veprimtari radiotelevizive kombëtare jepet për një kohë deri në 6 vjet për transmetimet në radio dhe 8 vjet në televizion, duke filluar që nga dita e botimit të vendimit për dhënien e licencës në Fletoren Zyrtare.

Licenca për veprimtari radiotelevizive lokale jepet për një kohë deri në 3 vjet për transmetime radiofonike dhe 5 vjet për transmetime televizive.

Kërkesa për rinovimin e licencës bëhet 90 ditë përpara afatit të përfundimit të saj. Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit vendos për rinovimin ose për shpalljen e konkurrimit të kandidaturave të reja, nëse operatori i licencuar nuk ka qenë i rregullt në zbatimin e këtij ligji.

Neni 26
Mosdhënia e licencës

Licenca nuk u jepet:

1. personave të cilëve me vendim të formës së prerë të gjykatës u është hequr zotësia për të vepruar;
2. partive dhe organizatave politike, komuniteteve dhe shoqatave fetare, autoriteteve të pushtetit lokal, si dhe çdo autoriteti tjetër shtetëror;
3. enteve publike me karakter ekonomik, bankave dhe instituteve të tjera të kreditit.

Neni 27
Licenca për radio dhe televizion

Të njëjtit subjekt mund t'i jepet licencë për transmetim për radio dhe televizion lokal në të njëjtin territor.

Neni 28
Kushtet financiare për dhënien e licencës

KKRT-ja verifikon nëse kapitali financiar i deklaruar dhe i nënshkruar i përgjigjet projektit teknik dhe programor të parashtruar në kërkesën për licencë.

Neni 29
Kushti për përmbajtjen e programeve

Për marrjen e licencës me shtrirje lokale duhet që të paktën 15 për qind e programeve javore të përmbajnë informacion dhe programe që lidhen me realitetin lokal, por që nuk kanë karakter tregtar.

Neni 30
Detyrimi për njoftimin e ndryshimeve

I licencuari detyrohet të njoftojë Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit për çdo ndryshim të të dhënave që ka paraqitur në kërkesën për marrjen e licencës ose për mosplotësimin e kushteve të caktuara në licencë, duke dhënë dhe arsyet përkatëse, paraprakisht dhe në çdo rast, jo më vonë se 15 ditë pas bërjes së këtyre ndryshimeve. Nëse ndryshimet merren parasysh, shpenzimet përkatëse i paguan i interesuari.

Neni 31
Ndryshimi i detyruar i kushteve të licencës

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ndryshon kushtet e përmendura në licencë edhe pa miratimin e mbajtësit të saj, në ato raste kur këto ndryshime diktohen nga respektimi i marrëveshjeve ndërkombëtare që ka nënshkruar Republika e Shqipërisë, duke dhënë kohën e duhur për zbatimin e ndryshimeve, nëse kjo është e mundur. Në këto raste shpenzimet i paguan KKRT-ja.

Neni 32
Fillimi i transmetimit

Transmetimi në bazë të licencës së dhënë fillon vetëm pas inspektimit teknik të projektit dhe të pajisjeve nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i cili konfirmon zyrtarisht me shkrim përputhjen e kushteve të licencës me ato të realizuara faktikisht.

Neni 33
Pavlefshmëria e licencës

Licenca bëhet e pavlefshme kur:

1. mbaron afati i vlefshmërisë dhe ajo nuk është rinovuar;
2. i licencuari heq dorë prej saj me shkrim;
3. Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ka nxjerrë vendim për heqje licence në bazë të kompetencave që i jep ky ligj;
4. deklarohet falimentimi;
5. kërkuesi nuk e tërheq licencën ose nuk realizon detyrimet financiare të parashikuara me ligj pas 90 ditëve nga momenti kur merr dijeni zyrtarisht për miratimin e saj.

Neni 34
Heqja e licencës

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ka të drejtë të heqë licencën e transmetimit kur:

1. është fituar sipas të dhënave të rreme të paraqitura në kërkesë;
 2. nuk plotësohen kushtet për të cilat është dhënë licenca;
 3. cenohen rëndë detyrimet e caktuara në këtë ligj dhe detyrime të tjera ligjore, që lidhen me transmetimin e programeve, në përputhje me nenin 137 të këtij ligji;
 4. nuk ka filluar transmetim pas hyrjes në fuqi të vendimit për dhënie licence për një periudhë kohe:
 - a) - 180 ditë në transmetimet e radios lokale;
 - 270 ditë në transmetimet e televizionit lokal;
 - b) - 1 vit në transmetimet e radios kombëtare;
 - 1 vit e gjysmë në transmetimet e televizionit kombëtar;
 5. pas fillimit të transmetimit, gjatë një viti kalendarik, nuk transmetohet 30 ditë, pa llogaritur ndërprerjet për arsye teknike që nuk varen nga mbajtësi i licencës;
 6. te mbajtësi i licencës kanë ndodhur ndryshime që e bëjnë të pamundur respektimin e kushteve të vendosura në licencë;
 7. prona e mbajtësit të licencës ka dalë në ankand për shitje.
- Kur hiqet licenca e transmetimit, mbajtësi i saj është i detyruar ta kthejë atë pa kërkuar

dëmshtëpërblim nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit.

KREU V PROGRAMET RADIOTELEVIZIVE

Neni 35

Program radioteleviziv

(Ndryshuar paragrafi I fundit me ligjin nr. Nr. 8655, datë 31.7.2000)

Programe radiotelevizive quhen tërësia e emisioneve që transmetohen nga një stacion i caktuar. Radioja dhe televizioni publik transmetojnë emisione me karakter informativ, edukativ, kulturor, artistik e argëtues.

Në programet radiotelevizive nuk lejohet censura.

Programet radiotelevizive respektojnë kufizimet e parashikuara me ligj, ato të nenit 10 të Konventës Europiane “Për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut” dhe të kreut “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut” të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

Neni 36

Programet radiotelevizive publike dhe private respektojnë dinjitetin vetjak dhe të drejtat themelore të njeriut, paanshmërinë, plotësinë dhe pluralizmin e informacionit, të drejtat e fëmijëve dhe të adoleshentëve, rendin publik dhe sigurinë kombëtare, gjuhën dhe kulturën shqiptare, të drejtat kushtetuese e njerëzore të shtetasve, të pakicave kombëtare në përputhje me konventat ndërkombëtare të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë, diversitetin fetar shqiptar.

Neni 37

Përdorimi i gjuhës shqipe është i detyruar për të gjitha programet, përveç veprave muzikore me tekst në gjuhë të huaj, emisioneve për mësimin e gjuhëve të huaja, emisioneve drejtuar posaçërisht pakicave kombëtare dhe programeve të subjekteve radiotelevizive lokale të licencuara për transmetim në gjuhën e minoriteteve.

Filmat në version original në kanalet kombëtare transmetohen të shoqëruar me subtitrimin dhe dublimin në gjuhën shqipe. Për radiot dhe televizionet lokale ky detyrim fillon të zbatohet një vit pas licencimit.

Radioja dhe televizioni publik dhe privat pasqyrojnë në veprimtarinë e tyre një kulturë gjuhësore në pajtim me normën e vendosur të gjuhës letrare kombëtare.

Përfshihen nga ky detyrim subjektet radiotelevizive të licencuara ndryshe.

Neni 38

Programet e ndaluara me ligj

Në radio dhe televizion nuk lejohet të jepen programe që nxisin dhunën, urrejtjen kombëtare, fetare e raciale, veprime antikushtetuese, ndarjen territoriale, diskriminimin për shkak të bindjeve politike dhe përkatësisë fetare.

Nuk lejohet gjithashtu:

1. transmetimi i informacioneve të cilat përbëjnë sekret shtetëror sipas ligjit dhe që i sjellin dëm sigurisë kombëtare;
2. transmetimi i informacioneve që cenojnë jetën private të shtetasve;
3. transmetimi i mesazheve të shifruara kundër interesave themelorë të shtetit;

4. prodhimi e transmetimi i programeve pornografike.

Neni 39

Informacionet që transmetohen pa shpërblim

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit përcakton me rregullore mesazhet me dobi shoqërore apo me interes të lartë për publikun e gjerë, të cilat rrjetet radiotelevizive publike dhe private detyrohen t'i transmetojnë pa shpërblim.

Organet e pushtetit dhe të administratës shtetërore lokale kanë të drejtë t'u kërkojnë të licencuarve për transmetime radiotelevizive lokale private të transmetojnë pa shpërblim komunikata të shkurtra, që paraqesin interes të veçantë për publikun e zonave ku ato transmetojnë dhe që kanë të bëjnë me shëndetësinë, fatkeqësi natyrore, rendin.

Transmetuesit nuk mbajnë përgjegjësi për përmbajtjen e këtyre mesazheve.

Neni 40

Kohëzgjatja e transmetimit për programet private

Transmetimet e programeve në radio ose televizion privat lokal detyrimisht duhet të kenë këtë kohëzgjatje:

1. Jo më pak se 6 orë në ditë transmetime në radio.
2. Jo më pak se 4 orë në ditë transmetime në televizion.

Transmetimet e programeve në radio ose televizion privat në shkallë kombëtare detyrimisht duhet të kenë këtë kohëzgjatje:

1. Jo më pak se 10 orë në ditë transmetime në radio.
2. Jo më pak se 6 orë në ditë transmetime në televizion.

Nuk konsiderohen programe transmetimet thjesht përsëritëse ose ato që janë me figura fikse.

Neni 41

Transmetimi i lajmeve

Radioja dhe televizioni publik e privat në shkallë kombëtare detyrohet të transmetojë çdo ditë lajme.

Lajmet dhe informacionet, që transmetohen nga operatorët radiotelevizivë në edicionet informative, i paraqesin faktet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë e të paanshme, nxisin formimin e lirë të mendimeve dhe nuk i shërbejnë në mënyrë të njëanshme interesave të asnjë partie apo organizate politike, grupimi ekonomik dhe komuniteti a shoqate fetare.

Neni 42

Regjistrimi dhe arkivimi i lajmeve

(Ndryshuar paragrafi 1 dytë me ligjin nr. 8794, datë 10.5.2001)

Lajmet që jepen në radio e televizion (publik e privat, kombëtar e lokal) duhet të regjistrohen e të ruhen për një periudhë 2-mujore pas ditës së transmetimit.

Lajmet dhe çdo program tjetër i regjistruar nuk përjashtohen nga dispozitat e ligjit nr. 7726, datë 29.6.1993 "Për fondin arkivor kombëtar dhe për arkivat", për aq sa është i mundur zbatimi i tyre.

Neni 43
Transmetimi i filmave
(Shtuar paragraf me ligjin nr. 8794, datë 10.5.2001)

Veprat kinematografike (përveç rasteve të marrëveshjeve midis transmetuesit dhe atij që ka të drejtën e autorit) mund të transmetohen në televizion vetëm 2 vjet pas shfaqjes së parë të kësaj vepre në sallat kinematografike të vendit të origjinës. Për veprat e prodhuara në bashkëpunim me kompanitë televizive ky afat reduktohet në 1 vit, kur me marrëveshje nuk vendoset ndryshe.

Filmat dhe programet, që janë të ndaluara të shfaqen në kinema, nuk shfaqen në televizion.

Filmat e ndaluar për fëmijët nën moshën 14 vjeç nuk shfaqen në televizion as pjesërisht prej orës 600 deri në orën 200 të ditës tjetër.

Në transmetimet e filmave zbatohen kërkesat e ligjit nr. 8096, datë 29.4.1996 “Për Kinematografinë”, si dhe të ligjit nr.7564, datë 19.5.1992 “Për të drejtën e autorit”, ndryshuar me ligjin nr.7923, datë 19.4.1995.

Për shkelje të dispozitave të ligjit për të drejtën e autorit, si dhe për shkelje të të drejtave që lidhen me transmetimet radiotelevizive, pala e interesuar i drejtohet gjykatës në përputhje dhe sipas procedurës së përcaktuar në ligjin për të drejtën e autorit.

Neni 44
Fshehtësia e burimeve të informacionit

Fshehtësia e burimeve të informacionit (përfshirë edhe materialet e hulumtuara nga gazetarët) është e garantuar. Zbulimi i tyre bëhet vetëm në raste të veçanta të parashikuara me ligj.

Neni 45
Përgjegjësia për programin e transmetuar

Gazetari dhe redaktori përgjegjës i materialit të transmetuar në radio ose televizion, publik ose privat, mbajnë përgjegjësi sipas rastit, penale ose civile, kur nga pavërtetësia e informacionit ose e programit të transmetuar, personave juridikë ose privatë u janë shkaktuar dëme materiale ose morale.

Neni 46
Pasqyra informative e shtypit

Pasqyra informative e shtypit të përditshëm dhe periodik në programet radiotelevizive bëhet vetëm me lejen e botuesve të secilit organ shtypi.

Neni 47
E drejta për përgënjeshttrim

Subjekti i prekur në interesat e tij morale ose materiale nga transmetimet e pavërteta, ka të drejtë t’i kërkojë subjektit radioteleviziv, publik ose privat, që të japë përkatësisht në radio ose në televizion përgjigjen përgënjeshtuese.

Përgjigjja transmetohet pa pagesë në edicionin e ardhshëm të të njëjtit program ose të të njëjtës kategori programesh.

Përgjigjja duhet të nënshkruhet nga pala e interesuar ose përfaqësuesi i saj ligjor dhe t'i përmbahet vetëm fakteve për të cilat ai e quan veten të prekur.

Subjekti që kërkon të drejtën për përgënjeshttrim provon që informacioni i transmetuar në adresë të tij është i gënjeshtërt dhe i është dëmtuar një interes i ligjshëm.

Nuk jepet e drejta e përgjigjes kur faktet për të cilat subjekti e quan veten të prekur kanë dalë gjatë sesioneve të Kuvendit Popullor apo gjatë gjykimeve në gjykatë.

Përgënjeshtrimi refuzohet të jepet në radio ose në televizion kur:

1. subjekti i interesuar nuk ka interesa legjitimë për publikimin e saj;
2. përgjegjja është shumë më e gjatë sesa deklarata cilësuese, për të cilën kërkohet të jepet përgjegjja;
3. kërkesa për përgjigje nuk është bërë brenda 2 muajve nga dita e dhënies së deklaratës që kundërshtohet.

Refuzimi i përgënjeshttrimit për arsyet e mësipërme jepet me shkrim.

Për mosrespektimin e të drejtës së përgënjeshttrimit, përgjegjësi i emisionit ndëshkohet sipas sanksioneve të parashikuara në këtë ligj.

Refuzimi i përgënjeshttrimit nga subjektet radiotelevizive bëhet objekt i apelimit në KKRT. Të dyja palët mund të ankimojnë vendimet e KKRT-së në gjykatë.

Neni 48

Bilancet vjetore dhe përmbajtja e tyre

Operatorët radiotelevizivë publikë e privatë janë të detyruar të hartojnë bilancet e tyre vjetore në përputhje me legjislacionin për kontabilitetin, të cilat i depozitojnë pranë KKRT-së. Në mënyrë të veçantë në to pasqyrohen të dhëna për programet e transmetuara, çmimet e tyre kur ato janë blerë ose shuma e harxhuar kur ato janë programe origjinale, të dhëna për reklamën e transmetuar ose veprimtari të tjera dhe të ardhurat përkatëse, sponsorizimet, si dhe lista e financuesve apo dhuruesve me shumën përkatëse dhe çdo shpërblim tjetër në favor të subjektit radioteleviziv publik ose privat.

KREU VI REKLAMA

Neni 49

Reklamë është çdo mesazh që synon të nxisë shitblerjen e një malli ose kryerjen e një shërbimi, duke paraqitur një ide për të arritur efektet që dëshiron reklamuesi të cilit i është dhënë kohë transmetimi me pagesë ose me një formë tjetër shpërblimi.

Neni 50

Kushtet për reklamën

Transmetuesit radiotelevizivë detyrohen të sigurojnë që reklamën:

1. të jenë me folës shqip ose me subtitime shqip;
2. të jenë të nderhme e të mos bëhen duke dëmtuar të tjerët;
3. të mos jenë mashtruese dhe të mos paragjykojnë interesat e konsumatorëve;
4. të mos bëhen nga spikerët e rregullt të lajmeve ose nga paraqitësit (paraqitëset) e programeve në një transmetues publik;

Nuk lejohen reklamën subliminale (që veprojnë në nënvetëdijen e shikuesit dhe për shkak të shpejtësisë së transmetimit nuk kapen nga shqisat e njeriut).

Neni 51

Forma e paraqitjes së reklamave

Reklamat transmetohen midis e brenda programeve të ndryshme, si dhe në programe të veçanta (programet-reklamë).

Në radio transmetimet e reklamave veçohen qartë nga pjesët e tjera të programit me ndihmën e mjeteve akustike, kurse në televizion me ndihmën e mjeteve optike dhe akustike. Në parim ato transmetohen në blloqe.

Lejohet transmetimi i programeve-reklamë në qoftë se shprehet qartë karakteri reklamues i programit dhe reklama është pjesë thelbësore e tij.

Programi-reklamë paraqitet si i tillë në fillim të emisionit dhe shoqërohet në fund me shënimin “program-reklamë”.

Neni 52

Ndërfutja e reklamave

Reklamat mund të futen ndërmjet programeve, si edhe në rastet e përshkruara më poshtë, brenda programeve, por duke mos dëmtuar integritetin dhe vlerën e tyre.

Në programe që përbëhen nga pjesë të pavarura ose në programe kulturore-sportive dhe ngjarje të tjera të ngjashme që përmbajnë intervale, reklamat ndërfuten vetëm midis pjesëve ose në intervalet. Në programet e tjera çdo ndërprerje për reklama nuk do të bëhet pa kaluar të paktën 20 minuta nga ndërprerja më e afërt.

Transmetimi i filmave (duke përjashtuar dokumentarët), kur zgjasin më shumë se 45 minuta, mund të ndërpritet një herë për çdo periudhë të plotë 45 minutshe me reklama që nuk i kalojnë blloqet e 2 minutave. Ndërprerja tjetër lejohet nëse filmi vijon të paktën edhe 20 minuta pas dy ose më shumë periudhave 45-minutshe.

Reklamat nuk ndërfuten në asnjë transmetim shërbimi fetar.

Emisionet e lajmeve, dokumentarët dhe programet e fëmijëve që janë më pak se gjysmë ore, nuk ndërpritën nga transmetimi i reklamave.

Neni 53

Kohëzgjatja e transmetimit të reklamave

Koha e transmetimit të reklamave në televizion nuk duhet të kalojë 15 për qind të kohës ditore të transmetimit.

Koha e transmetimit të reklamave televizive gjatë 1 ore transmetimi nuk duhet t'i kalojë 12 minutat.

Koha e transmetimit të reklamave në radio nuk duhet të kalojë 10 për qind të kohës së përgjithshme të transmetimit.

Kërkesat e këtij neni janë të detyrueshme për radiot dhe televizionet publike.

Neni 54

Arkivimi i reklamave

Reklamat e transmetuara ruhen të regjistruara sipas radhës së tyre për një kohë 1-vjeçare nga dita e transmetimit.

Neni 55

Dispozita ndaluese për reklamat

Nuk lejohet të transmetohen në radio dhe televizion:

1. reklamat që ushtrojnë ndikim në përmbajtjen e programeve;
2. reklamat që nxisin pornografinë dhe dhunën;
3. reklamat e produkteve të duhanit;
4. reklamat për armatimet dhe pajisjet ushtarake;
5. reklamat e tërthorta;
6. reklamat fetare ose ateiste;
7. reklamat e produkteve ushqimore të pamiratuara nga organet kompetente, sipas nenit 19 të ligjit nr.7941, datë 31.5.1995 “Për ushqimin”;
8. reklamat e partive ose shoqatave politike, përveç rasteve të parashikuara në ligjet elektorale;
9. reklamat e tjera që bien në kundërshtim me ligjet në fuqi.

Neni 56

Mbrojtja e të miturve

Nuk lejohet të jepen në radio e televizion reklama që nxisin sjellje, të cilat rrezikojnë shëndetin dhe zhvillimin normal psikik të fëmijëve.

Reklamat e destinuar për fëmijët ose kur realizohen me fëmijë, të jenë të tilla që të shmangin çdo gjë që dëmton interesat dhe veçantinë e moshës së tyre.

Neni 57

Reklamat e pijeve alkoolike

Reklamat e pijeve alkoolike të të gjitha llojeve u nënshtrohen këtyre kushteve:

1. Të mos u drejtohen në veçanti fëmijëve dhe ata të moslejohen të paraqiten në reklamë me pije alkoolike në duar ose në ndonjë mënyrë tjetër.
2. Të mos reklamohet konsumi i alkoolit në lidhje me përgatitjen fizike dhe energjinë apo me vlera terapeutike.
3. Të ndalohet propagandimi i përqindjes së alkoolit në pijet e reklamuar.
4. Të mos reklamohet konsumimi i tepërt i alkoolit.

Neni 58

Reklamat për barnat mjekësore

Ndalohen reklamat për barnat dhe trajtim mjekësor, të cilat jepen ose kryhen vetëm me recetë mjeku.

Ndalohen reklamat për barnat mjekësore që nuk janë prodhuar e miratuar sipas ligjit nr.7815, datë 20.4.1994 “Për barnat”.

Reklamat për barnat mjekësore të paraqesin në mënyrë të saktë e të plotë efektet e tyre vetëm sipas të dhënave e verifikimeve të deklaruara nga organet kompetente e sipas ligjeve përkatëse.

KREU VII SPONSORIZIMI

Neni 59

Sponsorizimi

Sponsorizim është financimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë nga një person fizik ose

juridik i një programi radioteleviziv, me qëllim që të reklamojë emrin, firmën prodhuese ose imazhin e këtij personi.

Çdo sponsorizim bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 60

Pasqyrimi i sponsorizimit

Kur një program ose seri programesh sponsorizohet plotësisht ose pjesërisht, kjo duhet të dalë e qartë në shënimet përkatëse në fillim dhe/ose në fund të programit.

Neni 61

Pavarësia nga sponsorizuesi

Në përmbajtjen dhe kohën e programeve të sponsorizuara, sponsorizuesi nuk lejohet të ndërhyjë në asnjë rast për të ndikuar në përgjegjësinë dhe pavarësinë redaktoriale të emisionit të sponsorizuar.

Neni 62

Ndalesa për sponsorizuesin

Në programet radiotelevizive të sponsorizuara nuk lejohet të bëhen referenca të veçanta për të nxitur shitjen ose blerjen, marrjen ose dhënien me qera, si dhe preferimin e shërbimeve të sponsorizuesit ose të një pale të tretë.

Neni 63

Ndalimi për sponsorizimet

Nuk lejohet të sponsorizohen programet nga persona juridikë ose fizikë kur veprimtaria kryesore e tyre është prodhimi, shitja ose ofrimi i shërbimeve, reklamimi i të cilave ndalohet sipas këtij ligji.

Emisionet e lajmeve dhe të ngjarjeve të ditës nuk sponsorizohen.

KREU VIII

RADIOTELEVISIONI PUBLIK SHQIPTAR

Neni 64

Emërtimi, vendndodhja

Radiotelevizioni publik Shqiptar është institucioni që kryen shërbim publik në fushën e radios dhe të televizionit.

Veprimtaria e Radiotelevizionit publik Shqiptar rregullohet me këtë ligj.

Neni 65

- Emri i Radiotelevizionit publik Shqiptar është Radiotelevizioni Shqiptar.
 - Emri i shkurtuar i institucionit është RTSH.
 - Emri i Televizionit publik Shqiptar është Televizioni Shqiptar (shkurt TVSH).
 - Emri i Radios publike Shqiptare është Radio Tirana (shkurt RT).
- Selia e RTSH-së është në Tiranë.

RTSH-ja përfshin edhe qendra rajonale radiotelevizive në territorin e Shqipërisë.

Neni 66

Deklarata e qëllimit

Si një transmetues i përkushtuar ndaj idealeve më të larta të transmetimit të shërbimit publik kombëtar, RTSH-ja realizon shërbime cilësore radioje dhe televizioni për të informuar, edukuar dhe argëtuar publikun, duke i shërbyer kombit, të gjitha grupeve të shoqërisë, përfshirë dhe pakicat kombëtare.

RTSH-ja zotohet për një mbulim të paanshëm të lajmeve të vendit dhe të atyre ndërkombëtare.

RTSH-ja realizon programe, të cilat duhet të pasqyrojnë te dëgjuesit dhe shikuesit e të gjitha moshave larminë e jetës shqiptare. RTSH-ja përgatit programe cilësore e me vlera për pasurimin e botës mendore dhe shpirtërore të njerëzve.

Neni 67

Programet radiotelevizive të RTSH-së

Programet radiotelevizive të RTSH-së realizohen në përputhje me deklaratën e qëllimit dhe kërkesat e nenit 36 të këtij ligji, si dhe me standardet profesionale.

Përveç plotësimit të kërkesave të nenit 36, RTSH-ja synon edhe:

- të mbështesë kulturën dhe krijimtarinë letrare dhe artistike shqiptare, duke nxitur lirinë e krijimit në forma nga më të ndryshmet;
- të edukojë dhe të zhvillojë kulturën e të folurit shqip sipas rregullave të drejtshkrimit.

Neni 68

Programi i RTSH-së në transmetimet e studiove qendrore dhe atyre rajonale siguron :

- shumëllojshmëri informacioni politik, social, kulturor dhe argëtues nga vendi dhe bota;
- dhënien e informacionit nga i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë;
- dhënien e informacionit për pakicat kombëtare;
- dhënien e informacionit për publikun jashtë vendit.

Neni 69

Programet e RTSH-së përcillen me anë të transmetimeve tokësore, satelitore dhe kablllore.

RTSH-ja siguron shërbime, duke përdorur edhe teknologjitë e reja të transmetimeve.

Neni 70

(Ndryshuar me ligjin nr. Nr. 8655, datë 31.7.2000)

RTSH-ja përfshin në transmetimet e saj:

- 2 programe televizive kombëtare;
- 2 programe radiofonike kombëtare;
- 1 program radiofonik në gjuhë të huaja dhe për bashkatdhetarët në AM;
- programet e qendrave radiotelevizive rajonale;
- 1 program satelitor radioteleviziv.

Neni 71

Programet kombëtare të RTSH-së duhet të mbulojnë territorin e banuar nga të paktën 90 për qind e shtetasve të Republikës së Shqipërisë.

Brenda 5 vjetësh nga dita e miratimit të këtij ligji, të paktën njëri nga programet e RTSH-së duhet të mbulojë 99 për qind të popullsisë.

Neni 72

Prodhimet e RTSH-së

Prodhimet e RTSH-së, bashkëprodhimet dhe prodhimi i porositur i programeve të përbëjnë të paktën 50 për qind të kohës së transmetimit.

Neni 73

(Shtuar paragraf me ligjin nr. 8794, datë 10.5.2001)

Prodhimi i porositur është pjesë e programeve të RTSH-së. Porositë realizohen nga subjekte të licencuar për prodhimin e programeve audio e video ose të filmave.

Bashkëprodhim është prodhimi i programeve në bashkëpunim mes RTSH-së dhe një subjekti të licencuar, ku secili prodhues angazhohet me potencialin e tij financiar e teknik.

Neni 74

RTSH-ja ofron konkurrencë publike për prodhimet e porositura sipas strukturës programore.

Neni 75

(Ndryshuar me ligjin nr. 8794, datë 10.5.2001)

Modalitetet për prodhimet e porositura dhe bashkëprodhimet përcaktohen në statutin e RTSH-së.

Neni 76

Për prodhimin e veprave audiovizuale që realizohen me porosi, RTSH-ja ka të drejtë të përdorë deri 25 për qind të buxhetit të saj të destinuar për prodhimet.

Neni 77

Të drejtat dhe detyrimet e RTSH-së

(Ndryshuar me ligjin nr. 8794, datë 10.5.2001)

RTSH-ja gëzon të drejtën e transmetimit ekskluziv për territorin e Republikës së Shqipërisë të veprimtarive kulturore, artistike dhe sportive me interes kombëtar, që organizohen nga institucione të administratës publike në nivel qendror ose vendor ose financohen nga Buxheti i Shtetit.

Veprimtaritë sportive të ekipeve kombëtare të Republikës së Shqipërisë transmetohen për territorin e Republikës së Shqipërisë ekskluzivisht nga RTSH-ja, në të gjitha rastet kur federatat ose komitetet shqiptare të lojrave ose ndonjë institucion tjetër publik shqiptar gëzojnë të drejtat e autorit ose të drejtat që lidhen me transmetimin e tyre.

Në çdo rast, RTSH-ja nuk mund të disponojë mbi të drejtat e autorit pa marrëveshjen

me shkrim me mbajtësit e këtyre të drejtave.

Neni 78

RTSH-ja përgatit kronika dhe reportazhe informative, pa qenë e detyruar të paguajë organizatorët e veprimtarive.

Neni 79

RTSH-ja bën regjistrimin e plotë të zërit dhe figurës të të gjitha programeve të transmetuara prej saj. Këto regjistrime ruhen për një periudhë jo më pak se 3 muaj.

Neni 80

Detyrimet e RTSH-së ndaj institucioneve shtetërore, publike dhe private

RTSH-ja transmeton ato seanca të punimeve të Kuvendit Popullor të përcaktuara në legjislacionin përkatës për zgjedhjet dhe referendumet.

Neni 81

Gjatë fushatave elektorale dhe referendumeve RTSH-ja vë në dispozicion të partive pjesëmarrëse kohë transmetimi falas sipas minutazhit të përcaktuar në legjislacionin përkatës për zgjedhjet dhe referendumet.

Neni 82

Institucioneve fetare nga RTSH-ja u vihet në dispozicion pa pagesë minutazhi i nevojshëm për transmetimin e ceremonive që kremtohen në datat e përcaktuara me ligj si festa zyrtare.

Neni 83

Për përmbajtjen e mesazheve të parashikuara në nenet 80, 81 dhe 82, përgjegjësi të plotë mban subjekti, të cilit i është dhënë kohë transmetimi.

Drejtori i përgjithshëm i RTSH-së pezullon transmetimin e këtyre mesazheve në ato raste kur përmbajtja e tyre dhunon në mënyrë të dukshme dhe serioze ligjet në fuqi. Këshilli Drejtues vendos për transmetimin ose jo të mesazheve të pezulluara nga drejtori i përgjithshëm.

Neni 84

RTSH-së i ndalohet propaganda politike dhe fetare.

Neni 85

(Shtuar paragrafi I dytë me ligjin nr. 8794, datë 10.5.2001)

RTSH-ja vë në dispozicion të operatorëve të tjerë radiotelevizivë mjedise në pronësi të saj për instalimin e pajisjeve transmetuese në bazë të marrëveshjeve dhe kontratave dypalëshe.

Tarifat e shfrytëzimit të mjediseve ose impianteve të RTSH-së për vendosjen dhe mbajtjen e pajisjeve transmetuese të operatorëve të tjerë radiotelevizivë dhe kontrata-tip përgatiten nga RTSH-ja në bazë të treguesve tekniko-ekonomikë. Këshilli Kombëtar i Radios

dhe Televizionit, pasi tërheq objeksionet e operatorëve radiotelevizivë, bën miratimin e tyre.

Modalitetet, duke përfshirë garancitë e një konkurrence të ndershme midis operatorëve radiotelevizivë, përcaktohen në rregulloren e KKRT-së në zbatim të nenit 7, pika 4 të këtij ligji dhe në statutin e RTSH-së.

Neni 86 **Organet drejtuese**

Organet drejtuese të RTSH-së janë:

- a) Këshilli Drejtues.
- b) Drejtori i përgjithshëm.
- c) Bordi i Administrimit.

Neni 87 **Këshilli Drejtues Përbërja dhe procedura e emërimit**

Anëtarë të Këshillit Drejtues janë personalitete publike të fushave të ndryshme, në: kulturë, art, kinematografi, gazetari, drejtësi, ekonomi, marrëdhënie me publikun, marrëdhënie ndërkombëtare, nga universitetet dhe Akademia e Shkencave, ekspertë të veprimtarisë radiofonike, televizione dhe të teknikës.

Neni 88

Këshilli Drejtues i RTSH-së përbëhet nga 15 anëtarë, të cilët zgjidhen nga Kuvendi Popullor.

Kandidaturat propozohen nga Komisioni i Përhershëm për Mjetet e Informimit Publik.

Komisioni i paraqet Kuvendit Popullor listën me dyfishin e kandidatëve, sipas përfaqësimit të mëposhtëm të partive, institucioneve dhe organizatave joqeveritare:

1) 6 anëtarë zgjidhen ndërmjet 12 kandidaturave të propozuara nga forcat politike, sipas përfaqësimit të tyre në Kuvendin Popullor.

2) Nga 1 anëtar ndërmjet 2 kandidaturave të propozuara drejtpërsëdrejti nga:

- Universitetet e Tiranës;
- Akademia e Shkencave;
- shoqatat e shkrimtarëve dhe artistëve;
- Forumi drejtues i OJQ-ve;
- shoqatat e gazetarëve;
- përfaqësues të sindikatave;
- përfaqësues të OJQ-ve të rinisë;
- përfaqësues të OJQ-ve të grave;
- përfaqësues nga pakica kombëtare.

Neni 89

Anëtarët e Këshillit Drejtues, të përcaktuar në pikën 2 të nenit 88, votohen në Kuvendin Popullor pasi subjekti kompetent, që ka të drejtë të caktojë përfaqësuesin e vet në KD të RTSH-së, ka sjellë në Komisionin e Përhershëm për Mjetet e Informimit Publik vendimin me dy kandidatura të firmosur nga titullari ekzekutiv.

Neni 90
Papajtueshmëritë

Anëtarët e Këshillit Drejtues të RTSH-së nuk mund të jenë deputetë, ministra, funksionarë të lartë shtetërorë apo anëtarë të forumeve drejtuese të organizatave politike.

Anëtarët e Këshillit Drejtues të RTSH-së nuk mund të jenë punonjës të RTSH-së dhe nuk duhet të kenë qenë të punësuar në RTSH 3 vitet e fundit.

Anëtarët e Këshillit Drejtues të RTSH-së nuk mund të jenë pronarë të plotë apo të pjesshëm të subjekteve private të medias apo të punësuar në këto subjekte.

Neni 91
Afati i qëndrimit në detyrë

Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues të RTSH-së zgjat 5 vjet. Secili anëtar i Këshillit Drejtues të RTSH-së mund të rizgjidhet për një mandat tjetër vetëm pas një ndërprerjeje 3-vjeçare.

Neni 92

Këshilli Drejtues i RTSH-së quhet i formuar në rast se në takimin e parë të thirrur nga kryetari i Këshillit Drejtues ekzistues ose nga 1/3 e anëtarëve të tij të sapozgjedhur, konstatohet se janë mbledhur 2/3 e anëtarëve që përbëjnë Këshillin Drejtues.

Mbledhja e parë thirret jo më vonë se 15 ditë nga dita e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Drejtues.

Neni 93

Anëtari i Këshillit Drejtues nuk hiqet gjatë kohës së ushtrimit të funksionit të tij, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

- kur nuk merr pjesë në mbledhjet e Këshillit Drejtues për 6 muaj rresht;
- kur funksionet që mund të marrë ndërkohë, bien në kundërshtim me këtë ligj;
- kur dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë;
- për paaftësi mendore;
- kur jep dorëheqje me shkrim.

Zëvendësimi bëhet duke respektuar përfaqësimin e përcaktuar në nenin 88. Zëvendësimi vazhdon deri në përfundimin e mandatit të anëtarit që zëvendësohet.

Neni 94

Këshilli Drejtues në mbledhjen e parë cakton afatin kohor për hartimin e rregullores së veprimtarisë së tij dhe zgjedh nga radhët e tij kryetarin dhe zëvendëskryetarin.

Kryetari i Këshillit Drejtues zgjidhet me shumicë relative të votave midis jo më pak se dy kandidaturave.

Neni 95

Mbledhja e zakonshme e Këshillit Drejtues zhvillohet kur janë të pranishëm mbi 50 për qind të anëtarëve të tij. Vendimet e Këshillit Drejtues janë të vlefshme kur për të kanë votuar më shumë se 1/3 e të gjithë anëtarëve.

Neni 96

Këshilli Drejtues mbledhet jo më pak se një herë në 2 muaj. Ai mund të mbledhet jashtë radhe sa herë që kryetari i Këshillit Drejtues, drejtori i përgjithshëm ose 1/3 e anëtarëve kërkojnë mbledhje.

Neni 97

Drejtori i përgjithshëm dhe kryetari i Bordit të Administrimit kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit Drejtues, përveç rasteve kur Këshilli vendos ndryshe.

Neni 98

Anëtarët e Këshillit Drejtues paguhet për ndihmesën e tyre me shpërblim mujor. Masa e shpërblimit është jo më pak se 1/5 e rrogës së drejtorit të përgjithshëm. Shpërblimi i kryetarit të Këshillit Drejtues është sa 1/4 e rrogës së drejtorit të përgjithshëm të RTSH-së.

Neni 99

Kompetencat e Këshillit Drejtues

Këshilli Drejtues ka këto kompetenca:

1. Miraton rregulloren e veprimtarisë së tij.
2. Miraton statutin e RTSH-së brenda 70 ditëve nga mbledhja e tij e parë. Në statutin e RTSH-së përcaktohet:
 - a) struktura e institucionit;
 - b) organet drejtuese dhe kompetencat e tyre;
 - c) kriteret dhe procedurat për emërimin dhe shkarkimin e zëvendës drejtorit të përgjithshëm, të drejtorëve të Radios dhe Televizionit, si dhe të shefave të departamenteve;
 - ç) përshkrimi i punës për të gjitha kategoritë e punonjësve;
 - d) përshkrimi i veprimtarisë ekonomike dhe financiare të RTSH-së.
3. Emëron dhe shkarkon drejtorin e përgjithshëm me 2/3 e votave sipas procedurës së përcaktuar në statut, jo më vonë se 1 muaj nga mbledhja e tij e parë.
4. Emëron dhe shkarkon zëvendës drejtorin e përgjithshëm dhe drejtorët e Radios dhe të Televizionit me shumicë të thjeshtë votash, sipas propozimeve të drejtorit të përgjithshëm, jo më vonë se 1 muaj pas emërimit të këtij të fundit.
5. Miraton anëtarët e Bordit të Administrimit të propozuar nga drejtori i përgjithshëm.
6. Miraton platformën, strukturën organizative dhe strukturën programore të RTSH-së.
7. Mbikëqyr paanshmërinë, objektivitetin dhe tërësinë e informacionit radioteleviziv.
8. Miraton kriteret kryesore për marrjen në punë, vlerësimin e punës dhe shpërblimin e punonjësve.
9. Këshillon drejtorin e përgjithshëm në lidhje me programet dhe ndihmon në caktimin e normave dhe të koncepteve programore në përputhje me ligjin.
10. Këshillon dhe ndihmon drejtorin e përgjithshëm në realizimin e përgjegjësiave programore.
11. Deklarohet me shkrim për transmetime të caktuara, që kanë shkelur parimet programore të parashikuara në këtë ligj. Ai këshillon drejtorin e përgjithshëm, pasi dëgjon opinionin e tij, dhe kërkon garanci për të parandaluar shkelje të tilla.
12. Harton raport për veprimtarinë vjetore të RTSH-së në përputhje me kërkesat e këtij neni dhe ia paraqet Kuvendit Popullor në fund të muajit mars të çdo viti.

Neni 100
Drejtori i përgjithshëm

Drejtori i përgjithshëm është menaxheri i veprimtarisë programore, financiare dhe të biznesit të RTSH-së.

Drejtori i përgjithshëm i RTSH-së zgjidhet me votim të fshehtë nga Këshilli Drejtues për një periudhë 5- vjeçare ndërmjet jo më pak se 2 kandidaturave.

Seleksionimi i kandidaturave bëhet nga Këshilli Drejtues mbi bazën e konkurrimit të hapur dhe kriterëve të përcaktuara në statutin e RTSH-së.

Neni 101

Drejtori i përgjithshëm i RTSH-së nuk lejohet të jetë deputet, anëtar i Qeverisë, anëtar i forumeve drejtuese të ndonjë partie politike, anëtar i Këshillit i Drejtues të RTSH-së, pronar, bashkëpronar apo anëtar i çfarëdo subjekti të mediave private.

Neni 102

Drejtori i përgjithshëm i RTSH-së ka këto të drejta dhe detyra:

1. Drejton veprimtarinë e RTSH-së në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të statudit të RTSH-së.

2. Emëron, liron dhe shkarkon, në përputhje me ligjet që rregullojnë marrëdhëniet e punës, të gjithë vartësit e tij, me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj dhe në statutin e RTSH-së parashikohet ndryshe.

3. Emëron, liron apo shkarkon nga detyra, vetë ose me propozim të drejtorëve të Radios dhe Televizionit, drejtuesit e departamenteve dhe të sektorëve.

4. Përgjigjet për programet në mënyrë që ato të jenë në përputhje me parimet e programimit të vendosura me këtë ligj.

5. Merr vendime që lidhen me çështje të organizimit, financave dhe pagave, pasi të jetë konsultuar me Bordin e Administrimit, në bazë të kriterëve të përcaktuara nga Këshilli Drejtues i RTSH-së.

6. Përfaqëson zyrtarisht RTSH-në brenda dhe jashtë vendit, si dhe në gjykatë.

7. Përgjigjet për ligjshmërinë në veprimtarinë e institucionit.

8. Bashkërendon punën e njësive administrative të sistemit të RTSH-së dhe zgjidh, brenda kompetencave të tij, mosmarrëveshjet e lindura midis tyre.

Neni 103

Drejtori i përgjithshëm lirohet nga detyra përpara afatit ligjor në rastet e mëposhtme, kur:

- shkel kompetencat që i jep ky ligj;
- kryen një vepër penale për të cilën është dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë;
- bëhet i paaftë për të kryer detyrën për shkak sëmundjeje;
- jep dorëheqjen me shkrim dhe kjo pranohet nga Këshilli Drejtues i RTSH-së.

Neni 104
Bordi i Administrimit të RTSH-së

Bordi i Administrimit është organ këshillimor i drejtorit të përgjithshëm për çështjet financiare të RTSH-së, të brendshme dhe të jashtme, përveç problemeve që kanë të bëjnë me programimin.

Neni 105

Bordi i Administrimit të RTSH-së përbëhet nga 5 anëtarë (3 të brendshëm dhe 2 të jashtëm), të cilët janë ekspertë në problemet e administrimit, financës dhe biznesit. Anëtarët e Bordit të Administrimit caktohen për një periudhë 4-vjeçare dhe mund të ricaktohen për dy periudha të tjera, në rast se gjatë kësaj kohe nuk kapërcejnë kufirin e moshës për pension.

Neni 106

Bordi i Administrimit emërohet nga Këshilli Drejtues i RTSH-së me votim të fshehtë dhe me shumicë të thjeshtë midis 8 kandidaturave të propozuara nga drejtori i përgjithshëm. Bordi zgjedh me shumicë të thjeshtë dhe me votë të fshehtë nga gjiri i vet kryetarin ndërmjet 2 kandidaturave.

Neni 107

Largimi nga detyra

Anëtarët dhe kryetari i Bordit të Administrimit, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm, largohen nga detyra para afatit ligjor në rastet kur:

- shkelin detyrimet me të cilat i ngarkon ky ligj dhe rregullorja e miratuar për veprimtarinë e bordit;
- vërehet se janë të paaftë për kryerjen e detyrës nga jo më pak se 8 anëtarë të Këshillit Drejtues;
- mungojnë pa arsye për katër mbledhje radhazi;
- dënohen për një vepër penale.

Neni 108

Papajtueshmëritë

Anëtarët e Bordit të Administrimit nuk lejohen të jenë anëtarë të Qeverisë, deputetë të Kuvendit Popullor, anëtarë të forumeve drejtuese të ndonjë partie politike ose të Këshillit Drejtues të RTSH-së.

Neni 109

Anëtarëve të Bordit të Administrimit nuk u lejohet që gjatë ushtrimit të funksionit të tyre të përfaqësojnë interesat e palëve të treta ose të jenë të lidhur me interesa biznesi në këtë fushë.

Neni 110

Mbledhjet e zakonshme të Bordit të Administrimit thirren 1 herë në muaj. Bordi bën edhe mbledhje jashtë radhe, kur një gjë të tillë e kërkojnë të paktën 2 prej anëtarëve të tij ose drejtori i përgjithshëm i RTSH-së.

Në mbledhjen e parë Bordi i Administrimit përcakton afatin për miratimin e rregullores së tij të brendshme, ku shpreh qartë procedurat e veprimtarisë së këtij organizmi. Rregullorja

miratohet nga Këshilli Drejtues i RTSH-së.

Neni 111

Vendimet e Bordit të Administrimit janë të vlefshme kur për to ka votuar shumica e anëtarëve të pranishëm. Kur numri i votave është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare.

Neni 112

(Ndryshuar pika 5 me ligjin nr. 8794, datë 10.5.2001)

Bordi i Administrimit të RTSH-së ka këto kompetenca:

1. Përpilon rregulla për çështjet financiare, të cilat miratohen nga drejtori i përgjithshëm.
2. Përpilon projektbuxhetin e RTSH-së, llogaritë vjetore dhe ndjek realizimin e tyre në emër të drejtorit të përgjithshëm.
3. Shqyrton leverdishmërinë e bizneseve në të cilat angazhohet RTSH-ja.
4. Shqyrton kontratat, shuma e të cilave kalon 5 % të buxhetit vjetor të RTSH -së.
5. Jep mendim për shpenzimet e paparashikuara në buxhet. Këshilli Drejtues i RTSH-së, miraton me vendim masat e propozuara nga Bordi i Administrimit, në lidhje me shpenzimet e paparashikuara në buxhet.
6. I paraqet drejtorit të përgjithshëm raporte dhe balance financiare, si dhe kryen detyra të tjera në përputhje me rregullat e përcaktuara në statutin e RTSH -së.
7. Kërkon dhe merr gjithë informacionin e nevojshëm për punën e tij nga departamentet dhe sektorët e RTSH-së.

Në rast konflikti midis drejtorit të përgjithshëm dhe Bordit të Administrimit, ky i fundit mund t'i drejtohet Këshillit Drejtues.

Neni 113

- Pëlqimi i Bordit të Administrimit është i domosdoshëm për veprimtaritë e mëposhtme:
- kontratat e punësimit, përfundimin e marrëveshjeve dhe negocimin e konflikteve me sindikatat;
 - blerjen, shitjen dhe lënien peng të pasurisë;
 - marrjen dhe shlyerjen e kredive bankare;
 - përfundimin e kontratave për investimet e reja, kur shuma për t'u investuar nga RTSH-ja është mbi 5-10 për qind e buxhetit vjetor të institucionit.

Neni 114

Bordi i Administrimit të RTSH-së shpërblehet për çdo mbledhje që bën. Masa e shpërblimit caktohet nga Këshilli Drejtues i RTSH-së.

Neni 115

Financimi i RTSH-së

RTSH-ja i siguron fondet financiare për krijimin, përgatitjen, transmetimin dhe përhapjen e programeve të veta nga burimet e mëposhtme:

- taksa mbi aparatin marrës për programet e RTSH-së, e miratuar sipas legjislacionit për taksat;
- kontratat me palë të treta për transmetime të ndryshme, duke shfrytëzuar kapacitetet e lira teknike;

- shërbime të tjera programesh;
- botimet e prodhimeve muzikore, video, audio, librave, gazetave, revistave që lidhen me programet;
- veprimtaritë koncertale dhe shfaqjet publike;
- veprimtari të tjera të përcaktuara nga statuti i RTSH-së;
- reklamat dhe publikimi i mesazheve të tjera të paguara;
- sponsorizimet dhe dhurimet;
- shitja e programeve të RTSH-së;
- buxheti i shtetit.

Neni 116

Tepricat e të ardhurave, pas mbulimit të shpenzimeve të kryera sipas relacioneve të paraqitura nga Bordi i Administrimit, përdoren nga RTSH-ja për të financuar prodhimin e programeve, transmetimin e tyre, mirëmbajtjen dhe funksionimin e rrjetit të transmetimit, pronë e RTSH-së, rinovimin teknologjik dhe shpërblimin e punonjësve.

Neni 117

- Buxheti i shtetit financon:
- shërbimin e radios për shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë;
 - shërbimin e radios për publikun e huaj (në gjuhë të huaj);
 - shërbimin televiziv për shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë;
 - projekte të rëndësishme teknike për futjen e teknologjive të reja për prodhim dhe transmetim;
 - projekte të rëndësishme prodhimi filmik ose veprimtari artistike të mëdha mbarëkombëtare.
 - orkestrën sinfonike të RTSH-së dhe kinematografisë;
- Masa e financimit përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit të shtetit.

Neni 118

Ministritë dhe institucionet e tjera shtetërore financojnë projekte të veçanta me rëndësi kombëtare në fushat e kulturës, të shkencës dhe të edukimit me miratimin e Këshillit Drejtues të RTSH-së.

Neni 119

Pagesa e taksës për aparatin marrës (Shtuar paragraf me ligjin nr. 8794, datë 10.5.2001)

Taksa paguhet për marrësit radiofonikë dhe televizivë individualë në përputhje me legjislacionin për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë.

Taksa për aparatin marrës vilet nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare dhe derdhet në llogarinë e RTSH-së në fund të çdo viti. Taksa i bashkëlidhet faturës së energjisë elektrike e ndarë në zë më vete. Përqindja e shërbimit për agjentin tatimor caktohet me ligjin për sistemin e taksave.

Neni 120

Në fillimin e çdo viti Këshilli Drejtues i RTSH-së bën analizën financiare të institucionit

në bazë të raportimit të Bordit të Administrimit, duke e bërë publik këtë raport në 3-mujorin e parë të vitit në mënyrën e caktuar nga statuti.

KREU IX PROGRAMET RADIOTELEVIZIVE ME KABËLL

Neni 121

Përkufizimi i programeve radiotelevizive me kabëll

Programe radiotelevizive kabllore janë transmetimi i zërit, figurës ose i të dyjave bashkë nëpërmjet një sistemi shpërndarës kabllor për marrje të njëkohshme të këtyre programeve nga dy ose më shumë pajtimtarë.

Neni 122

Përmbajtja e programeve radiotelevizive me kabëll

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr. Nr. 8655, datë 31.7.2000)

Programet radiotelevizive kabllore përfshijnë:

1. Ritransmetim të programeve që jepen në efir nga transmetues tokësorë dhe satelitorë, duke përfshirë gjithmonë programe të operatorëve publikë.
2. Ritransmetim të programeve të destinuara për qarqe të mbyllur televizivë si hotele, pensione, rezidenca turistike, fshatra turistike, anije, tragete, spitale, kinema, teatro dhe diskoteka.
3. Ritransmetim të prodhimeve audiovizive të regjistruara me mjete të ndryshme.
4. Transmetim të programeve të ndryshme të prodhuara vetë.

Neni 123

Licenca

Licenca për transmetim të programeve radiotelevizive kabllore jepet nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit për një kohë prej 6 vjetësh. Ajo mund të rinovohet me kërkesën e mbajtësit të licencës, e cila duhet të bëhet 3 muaj para përfundimit të licencës së parë.

Në licencë përshkruhet natyra e programeve që do të transmetohen, duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ky ligj. Të drejtat e të tretëve, veçanërisht të drejtat e autorit, nuk preken.

Subjektet që marrin licencë për transmetim radioteleviziv kabllor, detyrohen të paguajnë taksat sipas përcaktimeve në ligj.

Neni 124

Procedura për marrjen e licencës

Procedura dhe kërkesat e tjera të nevojshme për marrjen e licencës, si dhe të drejtat e detyrimet e subjekteve janë të njëjta me ato që parashikohen për licencat e transmetimeve radiotelevizive në efir të përshkruara në kreun IV të këtij ligji.

Neni 125

Përdorimi i linjave kabllore

Personat juridikë ose fizikë që kanë marrë licencë për transmetim radioteleviziv kabllor,

përdorin linjat kabllore të operatorëve të shërbimit publik. Kur nuk ka linja të disponueshme për këtë qëllim, instalimi dhe shfrytëzimi i rrjeteve kabllore për transmetim radioteleviziv bëhet me leje të posaçme nga organet kompetente.

Neni 126

Rregullat e shpërndarjes me kabëll të programeve radiotelevizive

(Ndryshuar me ligjin nr. Nr. 8655, datë 31.7.2000; ndryshuar me ligjin nr. 8794, datë 10.5.2001)

Për të realizuar transmetimin cilësor të zërit dhe të figurës për pajtimtarët nëpërmjet rrjeteve kabllore të telekomunikacioneve, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit, në bashkëpunim me Entin Rregullator të Telekomunikacioneve, përcakton rregullat dhe mënyrat e shpërndarjes së programeve radiotelevizive.

Neni 127

Leja për rrjetin kabllor

Leja për vënien në punë të rrjetit kabllor për transmetim radioteleviziv jepet nga Enti Rregullator i Telekomunikacionit në dy etapa:

1. Leja paraprake jepet nga ERT-ja brenda 15 ditëve nga data e kërkesës, duke u bazuar në licencën e transmetimit të lëshuar nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, si dhe në projektin e rrjetit kabllor për transmetim. Në lejen paraprake caktohet afati për përfundimin e punimeve.

2. Leja përfundimtare jepet nga ERT-ja brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të punimeve dhe pasi të jetë bërë kontrolli i zbatimit të projektit teknik dhe i pajisjeve të instaluar.

KREU X

PËRSËRITËSIT RADIOTELEVIZIVË

Neni 128

Përsëritësat e programeve të huaja televizive

(Ndryshuar me ligjin nr. Nr. 8655, datë 31.7.2000)

Përsëritësat janë aparatura transmetimi, të përbëra nga marrësat satelitorë ose antena marrëse tokësore, nga përsëritës televizivë ose radio, nga transmetues televizivë ose radio, të destinuar për marrjen dhe ritransmetimin e plotë, të pandryshuar dhe të njëkohshëm në efir brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të programeve televizivë ose radio që transmetohen nga stacionet e huaja në rrugë tokësore ose satelitore.

Neni 129

Kushtet për instalimin e pajisjeve përsëritëse

(Ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr. Nr. 8655, datë 31.7.2000; shtuar paragraf me ligjin nr. 8794, datë 10.5.2001)

Instalimi dhe shfrytëzimi i pajisjeve përsëritëse bëhet vetëm pasi është dhënë licenca përkatëse nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit.

Në caktimin e kanaleve dhe frekuencave për përsëritësat kanë përparësi kërkesat për kanale dhe frekuenca të subjekteve publike e private të licencuara.

Caktimi i kanaleve dhe frekuencave për përsëritësit e stacioneve të huaja radiotelevizive

bëhet duke respektuar përparësinë për transmetuesit ose përsëritësit e operatorëve radiotelevizivë vendas.

Neni 130

Kushtet për licencën

(Shtuar pika 6 me ligjin nr. Nr. 8655, datë 31.7.2000)

Licenca për transmetime radiotelevizive me përsëritës jepet pasi të plotësohen këto kushte:

1. Kërkuesi të gëzojë të gjitha të drejtat civile.
2. Stacionet e transmetuara nga përsëritësit të mos nxisin cenimin e rendit kushtetues të Republikës së Shqipërisë.
3. Përsëritësit të plotësojnë normat e mbrojtjes nga fatkeqësitë, si dhe normat teknike lidhur me instalimet elektrike.
4. Të paraqitet projekti teknik i instalimit të përsëritësve.
5. Karakteristikat teknike të përsëritësve të jenë në pajtueshmëri me normat ekzistuese për transmetimet radiotelevizive në vendin tonë dhe me normat teknike të rekomanduara nga organizmat ndërkombëtarë të specializuar në fushën e standardeve.
6. Kushte të tjera të përcaktuara nga KKRT-ja në rregulloren e saj për ritransmetimin e programeve të huaja televizive dhe radio në Shqipëri.

Neni 131

Anullimi i licencës

Licencat e dhëna për transmetime radiotelevizive me përsëritës anulohen kur:

1. nuk plotësohet qoftë edhe një nga kushtet për dhënien e licencës;
2. vërehen parregullsi të rënda ose të përsëritura në zbatimin e kushteve të vëna në licencë.

Neni 132

Numri i lejueshëm i përsëritësve

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit cakton numrin e përsëritësve për transmetime radiotelevizive që lejohen të funksionojnë për çdo zonë të territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 133

Ndryshimet në licenca për interes publik

Për nevoja të zhvillimit të radios dhe të televizionit publik e privat kombëtar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ka të drejtë të anullojë licencat e dhëna për përsëritës të veçantë ose të caktojë frekuenca të tjera për transmetim.

Neni 134

Moslejimi i ndryshimit të destinacionit të përsëritësve

Nuk lejohet ndryshimi i destinacionit të përsëritësve për t'i përdorur ata si transmetues të programeve radiotelevizive.

Neni 135

Moslejimi i ritransmetimit me kabëll i programeve satelitore nga individë

Nuk lejohet ritransmetimi me kabëll për qëllime fitimi i programeve satelitore nga individë që kanë pajisje marrëse të tilla.

KREU XI

TRANSMETIMET ME SATELIT

Neni 136

Shërbimet e programeve për publikun të përhapura me satelit i nënshtrohen ligjit në mënyrë të njëjtë dhe në të njëjtën masë, si dhe shërbimet për përhapjen e programeve kombëtare me rrjetin tokësor. Për këto shërbime do të zbatohet Konventa Europiane për televizionin.

KREU XII

SANKSIONET

Neni 137

(Shtuar pika 5 dhe 6 me ligjin nr. 8794, datë 10.5.2001)

Në rastet e shkeljes së dispozitave detyruese të këtij ligji, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit vendos sanksione administrative si më poshtë:

1. Paralajmërim.
2. Gjobë deri në 3 për qind të xhiros vjetore të të ardhurave.
3. pezullim i përkohshëm i licencës.
4. Reduktim i kohës së licencës.
5. Heqje e licencës.
5. Me gjobë nga 20 000 deri 200 000 lekë për rastin kur nuk siguron paanshmërinë në paraqitjen e fakteve dhe ngjarjeve.
6. Me gjobë nga 40 000 deri në 400 000 lekë për rastin kur nuk respektohet e drejta për përgënjeshttrim.

KKRT-ja përcakton shkeljet konkrete, të cilat ndëshkohen nga sanksionet e përcaktuara në këtë nen, duke zbatuar fillimisht si rregull sanksionin e paralajmërimit.

KKRT-ja vendos sanksionet e parashikuara në ligj jo më vonë se 1 vit nga data e kryerjes së shkeljes.

Kur KKRT-ja vëren shkelje të dispozitave ligjore, për të cilat me ligj vendosin sanksione organet e tjera shtetërore, atëherë ajo njofton këto të fundit.

Operatori i ndëshkuar mund të kundërshtojë vendimin e KKRT-së në rrugë gjyqësore brenda një muaji nga data e marrjes së njoftimit për ndëshkimin.

Neni 137/1

Inspektimi i veprimtarisë së të licencuarit

(Shtuar me ligjin nr. Nr. 8655, datë 31.7.2000)

Inspektimi i veprimtarisë së të licencuarit kryhet nga specialistë të administratës së KKRT-së. Këta specialistë pajisen me dokument të posaçëm identifikimi dhe quhen inspektorë.

Ata kryejnë inspektim në mjediset ku i licencuari zhvillon veprimtarinë e tij edhe pa e njoftuar paraprakisht atë, për të verifikuar zbatimin e dispozitave të këtij ligji, të kushteve të licencës dhe të rregulloreve të miratuara nga KKRT-ja.

I licencuari nuk ka të drejtë t'i ndalojë inspektorët për të kryer inspektim. Ai është i detyruar të bashkëpunojë me ta dhe t'u japë informacion, kur ata e kërkojnë një gjë të tillë. Inspektori, kur nevojitet ekspertizë e veçantë, mund të marrë ekspertë.

Neni 137/2

Blokimi i pajisjeve

(Shtuar me ligjin nr. Nr. 8655, datë 31.7.2000)

Inspektorët bllokojnë dhe mbyllin me vulosje pajisjet, kur për përdorimin e tyre nuk është marrë licencë, kur ato nuk janë të miratuara ose kur nuk plotësohen kushtet e licencës.

Pajisjet e bllokuara inventarizohen dhe sekuestrohen me kalimin e afatit 1-mujor nga data e bllokimit dhe më pas i jepen për shitje subjekteve të ngarkuara me ligj. Pjesa e të ardhurave nga shitja, që rregullohet me kontratën përkatëse ndërmjet Këshillit Kombëar të Radios dhe Televizionit dhe subjektit të mësipërm, kalon në buxhetin e shtetit.

Neni 137/3

Kundërvajtjet administrative

(Shtuar me ligjin nr. Nr. 8655, datë 31.7.2000)

Kur inspektorët e KKRT-së vërtetojnë se i licencuari ka shkelur dispozitat e këtij ligji, kushtet e licencës dhe rregulloret e miratuara nga KKRT-ja, kanë të drejtë:

1. të vendosin gjobë, në zbatim të nenit 137/4 të këtij ligji dhe të kërkojnë nga i licencuari marrjen e masave për ndreqjen e shkeljes, duke vendosur afat për realizimin e saj;
2. t'i propozojnë KKRT-së ndalimin e veprimtarisë së të licencuarit;
3. t'i propozojnë KKRT-së pezullimin e përkohshëm të licencës, reduktimin e kohës së vlefshmërisë së licencës ose heqjen e saj.

KKRT-ja, pasi shqyrton propozimin e inspektorëve në përputhje me pikat "2" dhe "3" të këtij neni:

- a) paralajmëron të licencuarin me shkrim, duke përcaktuar shkeljen e bërë;
- b) pezullon përkohësisht licencën e dhënë dhe redukton kohën e vlefshmërisë së licencës;
- c) heq licencën sipas nenit 34 të këtij ligji.

Për t'i dhënë të licencuarit mundësi të japë mendime, para marrjes së vendimit për ndalimin, reduktimin ose heqjen e licencës, KKRT-ja njofton të licencuarin për vendimin dhe arsyet e marrjes së këtij vendimi.

Nëse edhe pas dëgjimit të të licencuarit, KKRT-ja e miraton marrjen e vendimit, ai i jep të licencuarit një kopje. KKRT-ja e boton vendimin në Fletoren Zyrtare në numrin më të afërt të saj dhe në Buletinin e vet.

KKRT-ja ndjek zbatimin e vendimit.

KKRT-ja vendos sanksionet e parashikuara në ligj, jo më vonë se një vit nga data e kryerjes së shkeljes.

Neni 137/4

Gjobat

(Shtuar me ligjin nr. Nr. 8655, datë 31.7.2000)

Shkeljet e mëposhtëme, të kryera nga të licencuarit, kur nuk përbëjnë vepër penale, janë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

1. Me gjobë nga 20.000 deri 200.000 lekë për rastet kur:

- a) nuk siguron kohë të mjaftueshme në transmetim për informacionet, objekt i nenit 39

të këtij ligji;

b) eliminon, para afatit të përcaktuar në nenin 42 të këtij ligji, regjistrimin dhe arkivimin e lajmeve;

c) eliminon, para afatit të përcaktuar në nenin 54 të këtij ligji, regjistrimin e reklamave.

2. Me gjobë nga 60.000 deri 1.000.000 lekë për rastet kur:

a) nuk respektohen në transmetim kufijtë kohorë dhe territorialë të përcaktuara në kushtet e licencës;

b) nuk respektohen detyrimet e neneve 50, 51, 52, 53, 55, 56, 57 dhe 58 të këtij ligji për transmetimin e reklamave;

c) nuk respektohen detyrimet e neneve të kreut VII të këtij ligji për sponsorizimet;

ç) nuk respekton kushtet e licencës përsa i përket programeve të prodhuara në vend;

d) nuk njofton për ndryshimet që kanë ndodhur në të dhënat e paraqitura në kërkesën për licencë;

dh) ndalohej hyrja e inspektorëve në mjediset ku janë vendosur pajisjet radiotelevizive të të licencuarit ose nuk jepen të dhënat e kërkuara nga ata;

e) shkaktohen interferenca ndaj të një licencuari tjetër si rezultat i mosrespektimit të kushteve teknike në transmetim.

3. Me gjobë nga 500.000 deri 1.500.000 lekë për rastet kur:

a) kryen transmetime në një frekuencë tjetër të paautorizuar;

b) kryen transmetime me fuqi rrezatuese më të madhe se ato të autorizuar;

c) transmeton nga vende të ndryshme nga ato të shënuara në licencë;

ç) transmeton programe të ndaluara me ligj, të përcaktuara si të tilla në nenin 38 të këtij ligji;

4. Me gjobë deri në 4 milionë lekë për rastet kur një person instalon pajisje televizive ose radiojeje, duke dalë në transmetim në efir me figurë ose me zë pa autorizimin, licencimin e KKRT-së.

Kundër vendimit të dënimit me gjobë nga inspektori përkatës bëhet ankim në KKRT-ja brenda 10 ditëve nga data e dhënies së tij. Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit merr vendim brenda 30 ditëve nga data e dhënies së gjobës.

Kundër vendimit të dënimit me gjobë mund të bëhet ankimi brenda 5 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit në gjykatën e rrethit ku është kryer kundërvajtja, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu "Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative".

Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimi dhe ekzekutimi i vendimeve bëhet sipas ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative" me ndryshimet e plotësimet e mëvonshme.

Gjoba është titull ekzekutiv që vilet nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit dhe derdhet në Buxhetin e Shtetit.

Neni 137/5

Bashkëpunimi me organet e tjera

(Shtuar me ligjin nr. Nr. 8655, datë 31.7.2000)

Për ushtrimin e të drejtave që burojnë nga ky ligj, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit duhet të mbështetet nga autoritetet publike vendore dhe ato policore.

Ngarkohet Policia Tatimore në ekzekutimin e vendimeve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, lidhur me gjobat, sanksionet dhe heqjen e licencave.

DISPOZITA KALIMTARE

Neni 138

Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Kuvendi Popullor zgjedh edhe anëtarët e KKRT-së sipas procedurave të sanksionuara në ligj.

1 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Qeveria i cakton KKRT-së fondet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së saj, godinën, si dhe çdo infrastrukturë tjetër.

3 muaj pas dhënies së financimit nga Këshilli i Ministrave, sipas nenit 11, KKRT-ja fillon veprimtarinë e saj në bazë të këtij ligji.

Neni 139

Operatorët radiotelevizivë privatë dhe transmetuesit radiotelevizivë me përsëritës që kanë funksionuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të pajisen me licencë brenda 6 muajve nga fillimi i veprimtarisë së KKRT-së.

Neni 140

6 muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, RTSH-ja fillon të veprojë si institucion publik me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ky ligj.

Neni 141

Këshilli Drejtues i RTSH-së krijohet sipas këtij ligji brenda 50 ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

Neni 142

Këshilli Drejtues ekzistues kryen detyrat me të cilat e ngarkon ligji deri në mbledhjen e parë të Këshillit Drejtues, të zgjedhur sipas procedurave të përcaktuara nga ky ligj.

Neni 143

70 ditë nga krijimi i tij, Këshilli Drejtues i RTSH-së miraton statutin e RTSH-së , i cili brenda 15 ditëve në vazhdim i paraqitet për miratim Kuvendit Popullor.

Neni 144

Brenda 60 ditëve nga krijimi i tij, Këshilli Drejtues i RTSH-së përcakton drejtimet dhe standardet e programimit.

Neni 145

Funksioni i drejtorit të përgjithshëm të RTSH-së, deri në momentin e emërimit të drejtorit të ri, kryhet nga drejtori i mëparshëm, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 146

Bordi i Administrimit, pas miratimit të rregullores së tij të brendshme nga Këshilli Drejtues i RTSH-së, i propozon këtij ndryshimet strukturore që i gjykon të nevojshme.

Neni 147

Të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme që shfrytëzohen nga RTSH-ja, të tilla si: godinat administrative, radio-stacionet, pikat e transmetimit, objektet e MCR-së, të gjitha pajisjet teknike kalojnë në pronësi të këtij institucioni pa shpërblim, duke u pasqyruar në kontabilitetin e RTSH-së në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 148

Të gjitha frekuencat që janë në përdorim të RTSH-së, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji mbeten në dispozicion të këtij institucioni për një periudhë 10-vjeçare.

Neni 149

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr.7524, datë 19.11.1991 "Për statutin e RTSH", ligji nr.8221, datë 14.5.1997 "Për Radion dhe Televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë" dhe ndryshimet përkatëse, shfuqizohen.

Neni 150

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2230 datë 14.10.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

Lidhja 1

(Shtuar me ligjin nr. 8794, datë 10.5.2001)

**MASA E PAGESAVE PËR MARRJEN DHE RINOVIMIN E LICENCEVE PËR
RADIOT DHE TELEVISIONET PRIVATE**

Për transmetime radioje 15.000 lekë

Për transmetime televizive 20.000 lekë

**MASA E PAGESAVE VJETORE PËR LICENCË PËR RADIOT DHE
TELEVISIONET PRIVATE VENDORE DHE KOMBËTARE**

Për komuna e bashki :

Me popullsi deri 5.000 banorë

Për transmetime radioje 1.150 lekë

Për transmetime televizive 2.300 lekë

Me popullsi deri 10.000 banorë

Për transmetime radioje 1.500 lekë

Për transmetime televizive 2.860 lekë

Me popullsi deri 30.000 banorë
Për transmetime radioje 4.300 lekë
Për transmetime televizive 14.300 lekë
Me popullsi deri 50.000 banorë
Për transmetime radioje 8.600 lekë
Për transmetime televizive 25.800 lekë
Me popullsi deri 100.000 banorë
Për transmetime radioje 14.300 lekë
Për transmetime televizive 45.800 lekë

Me popullsi deri 200.000 banorë
Për transmetime radioje 21.500 lekë
Për transmetime televizive 71.500 lekë

Për zonë transmetimi më të mëdha:

Me popullsi deri 300.000 banorë
Për transmetime radioje 28.600 lekë
Për transmetime televizive 71.500 lekë

Me popullsi deri 400.000 banorë
Për transmetime radioje 34.300 lekë
Për transmetime televizive 85.800 lekë

Me popullsi mbi 400.000 banorë
Për transmetime radioje 40.000 lekë
Për transmetime televiziv 100.000 lekë

Për qytetin e Tiranës

Për transmetime radioje 42.300 lekë
Për transmetime televizive 114.300 lekë

Për transmetime kombëtare

Për transmetime radioje 1. 500.000 lekë
Për transmetime televizive 5.000.000 lekë